



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

RAPORTI I GJENDJES PERINATALE NË KOSOVË PËR VITIN 2019

*Departamenti i Mjekësisë Sociale
Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKSHPK*

**RAPORTI I GJENDJES
PERINATALE NË KOSOVË PËR
VITIN 2019**

*Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKSHPK
Prishtinë 2019*

Botuesi:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Copyright:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Përdorimi i të dhënave lejohet vetëm kur citohet burimi i të dhënave.

Parathënie

Publikimi “Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë për vitin 2019” përfshinë të dhënat në dispozicion të raportuara nga institucionet shëndetësore dhe Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK).

Në këtë publikim përfshihen të dhënat mbi definicionet, lindjet dhe vdekshmërinë e foshnjeve të ndarë sipas periudhave të ndryshme të jetës së foshnjeve. Të dhënat kryesore perinatale dhe lindjet janë të prezantuara sipas viteve 2000-2019. Lindjet janë të raportuara sipas niveleve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore publike dhe private.

Të porsalindurit janë të prezantuar sipas grup-peshës dhe mënyrës së lindjes.

Foshnjat e vdekura janë të prezantuara sipas moshës, gjinisë, moshës së nënës, rradhës së lindjes, statusit martesor dhe nivelit të edukimit të nënës.

Koeficientët e vdekshmërisë perinatale dhe infantile janë të prezantuara sipas komunave.

Falenderojmë të gjitha institucionet shëndetësore të Kosovës të cilat ofruan bashkëpunim në mbledhjen e të dhënave. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si informacion shumë i dobishëm për t’u njohur më mirë me gjendjen perinatale në Kosovë.

Ftojme të gjithë shfrytëzuesit e këtij hulumtimi për bashkëpunim duke dhënë vërejtje, komente dhe propozime me qëllim të ngritjes së cilësisë në këtë lëmi tejet të domodoshme për zhvillimin, planifikimin, organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor në Kosovë në dobi të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës.

Prof. Dr. Naser Ramadani, MD., PhD. C.M.I.S., C.I.E.H.

Drejtor ekzekutiv i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	6
PËRMBLEDHJE	7
DEFINICIONET	8
METODOLOGJIA	10
TË DHËNAT KRYESORE	12
LINDJET.....	13
VDEKSHMËRIA E FOSHNJEVER.....	18
VDEKSHMËRIA FETALE.....	21
VDEKSHMËRIA PERINATALE	21
PËRFUNDIMET	26
REKOMANDIMET	28
BIBLIOGRAFIA	29
ANEX	30

PËRMBLEDHJE

Në vitin 2019, sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë raportuar gjithsej 21,899 lindje, kurse 4,364 janë lindje jashtë Kosovës. Krahasuar me vitin paraprak kemi 971 lindje më pak. Nga gjithsej lindje në Kosovë, kemi 21,798 të lindur gjallë që krahasuar me vitin paraprak janë 963 të lindur gjallë me pakë. Në vitin 2019 ishin 101 të lindur vdekur.

Në institucionet shëndetësore 20.7% të lindjeve janë kryer me prerje cezariane.

Sipas të dhënave të ASK, shkalla e vdekshmërisë fetale është 4.6%, vdekshmëria neonatale e hershme 5.4%, vdekshmëria perinatale 10.0% dhe vdekshmëria infantile është 8.7%.

Përkundër përmirësimeve në shëndetin perinatal situata ende nuk është e kënaqshme. Problemi i raportimit, me theks të veçantë mos raportimi i vdekjeve maternale si gjendje e ndërlidhur me shëndetin perinatal që së bashku reflektojnë edhe cilësinë e kujdesit shëndetësor spjegon faktin pse vazhdon të mbetet sfida për Kosovën gjenerimi i indikatorëve të shëndetit perinatal sipas instrumentit European EURO-PERISTAT.

Rëndësia e shëndetit perinatal qëndron në reflektimin e gjendjes shëndetësore të vendit dhe cilësinë e sistemit shëndetësor prandaj është e paraparë edhe në objektivin e Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë.

Ky raport i dedikohet vendimmarrësve, institucioneve shëndetësore dhe profesionistëve shëndetësorë me qëllim identifikimit të situatës monitorimit të vazhdueshëm si dhe planifikimit të masave specifike adekuate në adresimin e problemeve rreth shëndetit perinatal.

DEFINICIONET

Indikatori Perinatal është indikator kyç dhe senzitiv i gjendjes shëndetësore dhe reflekton kujdesin prenatal, gjatë lindjes dhe kujdesin për të porsalindurit.

Poashtu reflekton si indikator i tërthortë për gjendjen shëndetësore të nënës, organizimin dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor.

Definicionet e indikatorëve janë shfrytëzuar nga korniza e treguesve të shëndetit të fëmijës dhe nënës e cila është produkt i grupit punues në nivel nacional dhe i përkrahur nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit në Republikën e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, IKSHPK dhe UNICEF-i.

I lindur nënkupton shpëputjen e tërësishme e fetusit të vdekur që peshon më shumë se 500 g apo të fetusit të gjallë nga trupi nënës pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënësisë.

I lindur gjallë nënkupton shpëputjen e tërësishme nga trupi i nënës të produktit të konceptimit, pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënësisë, i cili produkt pas ndarjes, merr frymë apo tregon shenja të jetës si p.sh të rrahurat e zemrës, pulsimit të kordonit të kërthizës apo lëvizje vullnetare të muskujve, pavarësisht nëse kordoni i kërthizës është prerë apo placenta është ngjitur.

I lindur vdekur: Vdekja para daljes apo nxerrjes prej nënës së vet e produktit të konceptimit pa marrë parasysh kohëzgjatjen e shtatzënësisë; vdekja është përcaktuar sipas faktit se pas ndarjes së tillë fetusit nuk merr frymë apo nuk tregon ndonjë shenjë tjetër jete, siç janë rrahjet e zemrës, pulsimet e kordonit umbilikal apo lëvizjet e përcaktuara të muskujve të vullnetshëm (ASK)

Shkalla e të lindurve të vdekur (Vdekshmëria fetale)

Numri i të lindurve të vdekur për 1,000 të lindur gjallë (të lindur gjallë dhe të lindur të vdekur). Vdekja e frytit mund të ndodhë para lindjes – gjatë shtatzënësisë dhe gjatë lindjes.

Për qëllime të krahasimeve kombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale (≥ 500 g ose ≥ 22 javë).

Për qëllime të krahasimeve ndërkombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale ($\geq 1,000$ g ose ≥ 28 javë).

Shkalla e vdekshmërisë perinatale

Numri i vdekjeve perinatale (të lindur të vdekur dhe vdekje të hershme neonatale) e shprehur për 1,000 të lindur gjallë.

Shkalla e vdekshmërisë neonatale (mortaliteti neonatal) definohet si numri i fëmijeve të lindur të gjallë që vdesin pa i mbushë 28 ditë të jetës (0-27 ditë) e shprehur për 1,000 të lindur gjallë brenda një viti kalendarik.

Vdekjet neonatale (vdekjet gjatë 28 ditëve të para të jetës së foshnjës) mund të ndahen në:

vdekjet e hershme neonatale, që ndodhin brenda 7 ditëve (0-6 ditë) të para të jetës dhe

vdekjet e vonshme neonatale që ndodhin pas ditës së 7, (7-27 ditë), por para se të përfundohet dita e 28-të.

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (Mortaliteti infantil)

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve paraqet numrin e foshnjeve të vdekura para moshës 1 vjeçare (0-11 muaj) të shprehur për 1,000 të lindur të gjallë, në një periudhë të caktuar kohore. Vdekshmëria e foshnjave paraqet probabilitetin që fëmija të vdesë para se t'i mbushë 1 vjet për 1,000 të lindur të gjallë.

Shkalla e vdekshmërisë maternale paraqet numrin e grave të vdekura nga ndonjë shkak që lidhet me (ose është shkaktuar nga) shtatzëninë (duke përfshirë shkaqe aksidentale apo të rastësishme) dhe vdekjet gjatë lindjes ose brenda 42 ditëve pas përfundimit të shtatzënisë, pavarësisht nga kohëzgjatja dhe vendi i shtatzënisë, e shprehur në 100,000 të lindur gjallë, për një periudhë të caktuar kohore.

Vdekje e vonshme maternale është vdekja e një gruaje nga shkaqe të drejtpërdrejta ose të tërthorta më shumë se 42 ditë, por më pak se një vit pas përfundimit të shtatzënisë.

Metodologjia

Për përpilimin e raportit janë përdorur të dhënat për vitin 2019 nga ASK-së për statistikat vitale si dhe të dhënat e raportuara nga institucionet shëndetësore dhe të përpiluara në raporte nga IKSHPK.

Regjistrimi dhe grumbullimi i të dhënave për statistikat vitale janë detajuar sipas institucioneve relevante dhe kompetente në çdo fazë të procesit.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave demografike në nivel nacional. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) gjegjësisht Departamenti i Sistemit të Informimit grumbullon të dhënat e raportuara nga institucionet shëndetësore dhe bënë raportimin e fenomeneve vitale përmes raporteve nga institucionet shëndetësore relevante, ndërsa Departamenti i Mjekësisë Sociale gjegjësisht njësia e Observatorit të Nënës, Fëmijës dhe Rinisë bënë analizën e indikatorit të disagreguar.

- ASK është përgjegjës për grumbullimin e të dhënave nëpër hapat si më poshtë: çdo institucion shëndetësor dhe zyrë e gjendjes civile ka plotësuar Fletëzat statistikore për vdekje DEM-2
- Në baza mujore, institucionet shëndetësore dhe zyrat e gjendjes civile kanë raportuar në zyrat regjionale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), duke dorëzuar kopjet fizike të të gjitha DEM-2 të plotësuar.
- Zyrat regjionale të ASK, me pasqyrën mujore të të dhënave për lindje dhe vdekje DEM-5, kanë raportuar në ASK.
- Departamenti i statistikave sociale – sektori i statistikave vitale në ASK, ka kontrolluar cilësinë dhe ka konfirmuar të gjitha të dhënat.
- Të gjitha të dhënat janë futur në programin Access në Departamentin e IT-së.
- Sektori i statistikave vitale ka kontrolluar të dhënat në databazën e vdekjeve dhe ka përpunuar të dhënat me SPSS.
- ASK ka publikuar në faqen e internetit raportin “Statistikat e vdekjeve”
- Grumbullimin e të dhënave nga institucionet shëndetësore relevante dhe kalkulimin e indikatorit të disagreguar sipas gjinisë, komunave, moshës si dhe prezantimin e trendit e ka realizuar IKSHPK, Departamenti i Mjekësisë Sociale, Njësia e Observatorit të Nënës, Fëmijës dhe Rinisë.

Sfidat për grumbullimin e të dhënave:

- Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) sfida është mungesa e pyetësorit të standardizuar nga tri institucionet (Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Ministria e Shëndetësisë, IKSHPK). Gjatë vitit 2019 është punuar në unifikimin e formularit për raportim.
- Përfshirja në raportim e të gjitha komunave të Kosovës.
- Përkundër ekzistimit të qarkores në fuqi për raportim të vdekjeve maternale, asnjë vdekje maternale nuk është raportuar nga institucionet shëndetësore gjatë vitit 2019, prandaj edhe nuk ka reflektim të këtij indikatorit në Raportin Perinatal 2019.
- Mungesa e analizimit të Shkaqeve të vdekjeve për vitin 2019 në nivel nacional gjë që reflekton në orientimin e masave intervenuese.
- Mortaliteti perinatal si indikator ndikohet prej faktorëve tjerë jashtë sistemit shëndetësor dhe jo vetëm brenda kujdesit shëndetësor.
- Në Raportin Perinatal për vitin 2019 janë përfshirë vetëm disa prej indikatorëve bazikë dhe vazhdon të mbetet sfida për Kosovën gjenerimi i indikatorëve të shëndetit perinatal sipas instrumentit Europian EURO-PERISTAT.

TË DHËNAT KRYESORE

Indikatorët e shëndetit të grupeve vulnerabile të popullatës, të porsalindurve dhe nënave, janë tregues të rëndësishëm të shëndetit dhe mirëqenies së popullatës. Sipas raportit European, çdo vit në Evropë ka më shumë se 40,000 familje që kanë humbur një fëmijë. Nga raporti i fundit i vitit 2015, normat e lindjes së foshnjeve dhe vdekja neonatale, foshnjore dhe amtare ishin më të ulëta për foshnjat dhe gratë në Evropë sesa në pjesët e tjera të botës.

Sipas Raportit European Perinatal 2015, shkalla e vdekshmërisë fetale mesatare ishte 2.7 për 1000 lindje. Shkallët nën 2,3 për 1,000 lindje janë raportuar në Qipro, Islandë, Danimarkë, Finlandë dhe Hollandë, ndërsa mbi 3.5 për 1,000 lindje u raportuan në Sllovaki, Rumani, Hungari dhe Bullgari.

Për shkallën e vdekshmërisë neonatale mesatarja evropiane ishte 2.2 për 1,000 lindje të gjalla. Vendet me shkallë të vdekshmërisë neonatale 1.5 për 1,000 të lindur gjallë ose më të ulët ishin raportuar në Slloveni, Islandë, Finlandë, Norvegji, Republikën Çeke, Estoni dhe Suedi, ndërsa Irlanda e Veriut, Malta, Rumania dhe Bullgaria kishin norma mbi 3.5 për 1,000 foshnje të lindura gjallë.

Të dhënat perinatale kryesore për vitin 2019 në Kosovë, të raportuara nga institucionet shëndetësore publike dhe private janë:

- 21,899 lindje gjithsej, prej tyre 4,364 jashtë Kosove
- 21,798 të porsalindur gjallë
- 101 të lindur vdekur
- raporti gjinor në lindje është 1,106 meshkuj në 1,000 femra
- shkalla e lindjeve me prerje Cezariane është 20.7 %
- gjithsej 189 foshnje të vdekura
- 101 (4.6‰), vdekje fetale
- 118 (5.4 ‰) vdekje të hershme neonatale (0-6 ditë)
- 219 (10.0‰) vdekje perinatale (vdekje fetale + hershme neonatale)
- 48 (2.1‰) vdekje të vonshme neonatale (7-27 ditë)
- 166 (7.4‰) vdekje neonatale (0-28 ditë).

Shkalla e vdekshmërisë perinatale për të posalindurit me peshë $\geq 1,000$ gram që shfrytëzohet për krahasime ndërkombëtare është 10.0‰ (vdekshmëria fetale 4.6‰ dhe vdekshmëria e hershme neonatale 5.4 ‰).

Tabela 1. Të dhënat kryesore perinatale për vitin 2018

#	Modalitetet	2019
1	Numri i lindjeve	21,899
2	Numri i të posalindurve të lindur të gjallë	21,798
3	Numri i vdekjeve fetale	101
4	Shkalla e vdekshmërisë fetale (‰)	4.6
5	Numri i foshnjave të vdekura në javën e parë	118
6	Shkalla e mortalitetit të hershëm neonatal (‰)	5.4
7	Shkalla e vdekshmërisë perinatale (‰)	10.0
8	*Shkalla e lindjeve me prerje cezariane (‰)	20.7

Burimi: ASK-Raportet: Lindjet, Vdekjet për 2019, *IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2019

LINDJET

Në vitin 2019, sipas të dhënave të ASK-së, janë raportuar gjithsej 21,899 lindje, 4,364 janë lindje jashtë Kosovës, të lindur gjallë 21,798, dhe 101 të lindur të vdekur . Sipas IKSHPK-së janë raportuar gjithsej 22,110 lindje (lehona), prej tyre 22,343 të lindur gjallë dhe 145 të lindur vdekur. Numri i të lindurve gjallë më i lartë se numri i lehonave (lindjeve) spjegohet me faktin se fëmijët e lindur kanë qenë bineq apo treneq. Diferenca e numrit të lindjeve nga ASK dhe IKSHPK për vitin 2019 tregon përaftrim të të dhënave krahasuar me vitin paraprak (për vitin 2019 diferenca është për 211 lindje). Për të lindurit gjallë, për vitin 2019 kemi diferencë mes ASK dhe IKSHPK-së, për 545 të lindur gjallë, gjë që tregon përmirësim në raportimin e të dhënave. Mirëpo, për vitin 2019 diferenca është më e madhe për vdekjet fetale, me 44 të lindur vdekur më shumë të raportuar në IKSHPK. (Tab.2)

Tab.2. Raportimi i të dhënave nga dy burimet e të dhënave

Institucioni	Gjithsej lindje (Lehona)	Foshnje të lindur gjallë	Të lindur vdekur
IKSHPK	22,110	22,343	145
ASK	21,899	21,798	101
Diferenca	211	545	44

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2019
ASK-Statistikat e Lindjeve, 2019

Bazuar në raportin e IKSHPK-së: “Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2019”, sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në spitalet e përgjithshme me 11,784 apo 53.3%, pason klinika obstetrike gjinekologjike e QKUK-së me 9,461 lindje apo 42.8%, në maternitete 278 lindje apo 1.3%, ndërsa në spitalet private (Bahceci, Amerikan, Lindja, Sirona, European Klinik dhe Fati im) 587 raste ose 2.7% (Tab.3).


Tab.3. Lindjet sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, institucionit, Kosovë-2019

Institucioni	Gjithsej lindje (Lehona)		Gjithsej foshnje të lindura		Gjithsejfoshnje të lindur gjallë	
	N	%	N	%	N	%
QKUK	9,461	42.8	9,734	43.3	9,642	43.2
Spitali	11,784	53.3	11,862	52.8	11,824	52.9
Maternitetijashhtëspitalor	278	1.3	278	1.2	277	1.2
Institucione Publike	21,523	97.3	21,874	97.3	21,743	97.3
Institucione Private	587	2.7	604	2.7	600	2.7
Gjithsej	22,110	100.0	22,478	100.0	22,343	100.0

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2019

Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2019 kishte gjithsej 21,899 lindje, prej tyre 21,798 (99.5%) të lindur të gjallë, 101 të lindur të vdekur (Tab.1). Lindje të gjalla sipas gjinisë ishin: Femra 10,346 (47.5 %), meshkuj 11,452 (52.5%) dhe koeficienti i maskulinitetit në lindje 1,106.9‰.

Sipas komunave më së shumti të lindur gjallë kishte në komunën e Prishtinës me 3,266 (12.4%) komunën e Prizrenit me 2,633 (10.0%) dhe komunën e Ferizajit me 1,707 (6.5%). (Graf.1).




Graf.1. Struktura e lindjeve sipas komunave, 2019

Burimi: ASK-Statistikat e Lindjeve, 2019

Trendi i lindjeve


Gjatë periudhës kohore 2000-2019 ka trend të rënies së numrit të lindjeve, me rënie mesatare prej 739 lindje në vit dhe determinim të saktësisë së vijës së trendit me 82.7%. (Graf.2).



Graf.2. Trendi i lindjeve, Kosovë 2000-2019

Burimi: Statistikat e Lindjeve, 2019


Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore më i larti është në klinikën Gjinekologjike Obsterike të QKUK-së me 25.9 lindje, pason Prizreni me 8.5 lindje, Gjakova me 5.2 lindje dhe më së paku në Vushtrri me 1 lindje në ditë (Graf. 3).



Graf.3. Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2019

Lindshmëria për periudhën 2000-2019 ka trend të rënies me lëvizje variabile. Gjatë vitit 2000, lindshmëria për 1,000 banorë apo nataliteti ishte 19.3%, ndërsa në vitin 2019 ishte 12.2 %. (Graf.4)



Graf.4. Trendi i natalitetit, Kosovë 2000-2019

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2019

Të porsalindurit sipas peshës trupore në lindje me pjesëmarrje më të madhe në lindje kishte grup pesha 3000-3499g me 37.0% dhe grup pesha 3500-3999g me 30.6%. Pjesëmarrje më të vogël në lindje kishte grup pesha më pak se 1000g me 02%. (Tab.4)

Tab.4. Të porsalindurit sipas peshës trupore

Gjithsej lindje të gjalla	P esha në l i n d j e									
	Më pak se 1000	1000-1499	1500-1999	2000-2499	2500-2999	3000-3499	3500-3999	4000-4499	4500 e më shumë	E panjohur
21798	43	99	199	780	2733	8071	6679	2155	304	735
100	0.2	0.5	0.9	3.6	12.5	37.0	30.6	9.9	1.4	3.4

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2019

Sipas grup-moshës të nënës, 7,749 (35.5%) të lindur gjallë janë nga nënat e grup-moshës 25-29 vjet, pasojnë nënat e grup-moshës 30-34 vjet me 5,819 (26.7%). Moshë mesatare e nënave ka qenë moshë 29 vjeçe. (Tab.5)

Tab.5. Të lindurit gjallë sipas grup-moshave të nënës, 2019

Gjithsej lindje të gjalla	Grup moshë e nënës										Moshë mesatare
	14 e me pak	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50 e më shumë	E pa njohur	
21798	4	610	4063	7749	5819	2871	593	61	15	13	
100.0	0.0	2.8	18.6	35.5	26.7	13.2	2.7	0.3	0.1	0.1	29

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2019

Në vitin 2019 sipas të dhënave të ASK-së nga gjithsej 21,899 lindje, 21,284 prej tyre kishin lindur nga një foshnje, 594 lindje binjak dhe 21 prej tyre trenjak. (Tab. 6)

Sipas gjinisë të të porsalindurve 10,346 apo (47.5%) janë të gjinisë femërore dhe 11,452 apo (52.5%) të gjinisë mashkullore.

Sipas vendit ku ka lindur fëmija, 21,779 (99.9%) kanë lindur me ndihmë profesionale dhe vetëm 19 apo 0.1 % te fëmijëve në vend tjetër (Tab. 7)

Tab.6.Foshnje të lindura sipas numrit

Fëmijë të lindur	Një	21,284
	Binjak	594
	Trenjak	21
	Gjithsej	21,899

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2019

Tab.7. Të lindur gjallë sipas gjinisë dhe vendit ku ka lindur fëmija, 2019

		Gjinia		Vendi ku ka lindur fëmija	
		Femra	Meshkuj	maternitet apo spital	Në vend tjetër
Të lindur gjallë					
N	21798	10346	11452	21779	19
%	100.0	47.5	52.5	99.9	0.1

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2019

Në institucionet shëndetësore raportohen 4,580 (20.7 %) lindje me prerje Cezariane, në institucionet publike nga gjithsej **21,523** lindje, 4,105 (19.1%) janë me prerje cezariane ndërsa në institucionet private nga gjithsej 587 lindje 475 apo (80.9%) janë me prerje Cezariane (Tab.8, Graf.5).


Në klinikën Gjinekologjike Obstetrike të QKUK-së, 1,725 (18.2%) e lindjeve janë me prerje Cezariane. Sipas spitaleve, përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariane është realizuar në spitalin e Pejës 676 (38.3%), pason spitali i Gjakovës me 630 (33.5%) dhe spitali i Vushtrrisme 116 (33.4%) (Tab.8).

Në spitale private kanë raportuar 475 lindje me prerje cezariane (80.9%). Nëse krahasojmë me 4 vitet paraprake, ka rënie të lindjeve me prerje cezariane sipas viteve prej vitit 2015 deri në vitin 2018, nga 27.3% në 18.2%, por prap ngritje të lindjeve me prerje cezariane në vitin 2019 me 20.7% (Tab.8).

Tab.8. Lindjet me prerje Cezariane sipas institucioneve shëndetësore, Kosovë 2019

#	Institucioni		Komuna	Lindje me prerje Cezariane		Gjithsej lindje
				N	%	
1	Institucionet publike	QKUK	Prishtinë	1,725	18.2	9,461
		Spitali i përgjithshëm	Ferizaj	225	13.9	1,621
		Spitali i përgjithshëm	Gjakovë	630	33.5	1,881
		Spitali i përgjithshëm	Gjilan	466	28.9	1,615
		Spitali i përgjithshëm	Mitrovicë	239	16.6	1,438
		Spitali i përgjithshëm	Pejë	676	38.3	1,764
		Spitali i përgjithshëm	Prizren	28	0.9	3,118
		Spitali i përgjithshëm	Vushtrri	116	33.4	347
	Maternitetet jashtëspitalore			0	0.0	405
Gjithsej në Institucione publike				4,105	19.1	21,523
2	Institucionet private	Bahceci Healthcare	Prishtinë	48	96.0	50
		Spitali Amerikan Kosovë	Prishtinë	269	82.2	328
		Spitali Sirona	Prishtinë	109	76.8	142
		Sp.privat "European Clinic"	Gjakovë	48	72.7	66
		Sp.privat "Fati Im"	Gjakovë	1	100.0	1
	Gjithsej në institucione private				475	80.9
3	Gjithsej			4,580	20.7	22,110

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2019



Graf. 5. Struktura e lindjeve sipas mënyrës së lindjes

Burimi: IKSHPK – Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2019

VDEKSHMËRIA E FOSH NJEVE

Gjatë vitit 2019, institucionet shëndetësore publike dhe private kanë raportuar gjithsej 189 foshnje të vdekura. Prej gjithsej 189 foshnjeve të vdekura, 113 (59.8%) janë vdekje neonatale të hershme, (foshnje të vdekura 0-6 ditë), vdekjet neonatale (0 deri 27 ditë) përbëjnë 161 (85.2%), vdekje neonatale të vonshme janë 48 (25.4%) dhe 28 (14.8%) janë vdekje postneonatale (Tab.9, Graf 6).


Shkalla e vdekshmërisë sipas moshës është si vijon: Mortaliteti neonatal i hershëm 5.4%, mortaliteti neonatal i vonshëm 2.1% dhe mortaliteti postneonatal 1.2% (Graf. 7).

Mortaliteti infantil në Kosovë për vitin 2019 ishte 8.7 %. Sipas komunave, më i larti është në komunën e Novobërdës me 19.6%, Kaçanikut 13.8% dhe Prishtinës me 13.3%. (Tab.14)

Tab. 9. Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës

Foshnje të vdekura	Deri në 24 orë	1 – 6 ditë	7 – 27 ditë	1 – 11 muaj	Gjithsej
N	28	85	48	28	189
%	14.8	45.0	25.4	14.8	100.0

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2019



Graf.6. Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2019

Nga gjithsej 189 foshnje të vdekura 97 apo 51.3% janë meshkuj dhe 92 apo 48.7% femra. Vdekshmëria e foshnjeve sipas gjinisë, moshës së nënës dhe rradhës së lindjes së fëmijës nuk ka dallim sinjifikant (Tab.10).

Tab.10. Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës, gjinisë,moshës së nënës dhe rradhës së lindjes së fëmiut

Modalitete		Gjithsej		Moshë e foshnjeve të vdekura		
				Neonata e hershme	Neonatale	Post neonatale
				N	%	N
			189	118	45	26
			100.0	62.4	23.8	13.8
1	Gjinia	Meshkuj	97	58	26	13
		Femra	92	60	19	13
	$X^2 = 0.99$; Shl=2; P=0.60					
2	Moshë e nënës	15 – 24	32	20	7	5
		25 – 34	112	71	24	17
		35+	42	25	13	4
	$X^2 = 2.07$; Shl=4; P=0.72					
3	Radha e lindjes së fëmijës	Fëmija i parë	83	50	16	17
		I dyti	53	33	14	6
		I treti	28	18	9	1
		I katërti	15	11	3	1
	$X^2 = 7.7$; Shl=6; P=0.26					


Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2019

Sa i përket nivelit të edukimit 83 (43.9%) nga 189 foshnje të vdekura janë të nënave me shkollë të mesme dhe 41 (21.7 %) të nënave me shkollë fillore të kryer (Tab.11).

Tab.11. Vdekshmëria e foshnjeve sipas statusit martesor dhe nivelit të edukimit të nënës

Statusi martesor dhe niveli i edukimit të nënës		Moshë e foshnjeve të vdekurve			
		Gjithsej	Neonatal e hershme	Neonatale	Postneonatale
Statusi martesor ri nënës	E pamartuar	16	11	2	3
	E martuar	167	102	42	23
	E ve	0	0	0	0
	E shkurorëzuar	1	1	0	0
	E panjohur	5	4	1	0
	Gjithsej	189	118	45	26
	%	100.0	62.4	23.8	13.8
Niveli i edukimit të nënës	Pa shkollë	13	7	5	1
	Shkolla fillore e pa kryer	4	2	2	0
	Shkolla fillore e kryer	41	26	12	3
	Shkolla e mesme	83	51	15	17
	Shkolla e lartë	2	1	1	0
	Fakulteti	19	13	5	1
	E panjohur	27	18	5	4
	Gjithsej	189	118	45	26
	%	100	62.4	23.8	13.8

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2019



Graf.7. Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2019

VDEKSHMËRIA FETALE

Sipas IKSHPK, departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH), numri i foshnjeve të lindura vdekur për vitin 2019 ka qenë 145 me vdekshmëri fetale prej 6.5%.


Sipas niveleve të Kujdesit Shëndetësor 92 vdekje fetale (63.4%) kanë ndodhë në QKUK, 48 (27.9%) në spitale dhe në maternitete jashtëspitalore 1 (0.7%) (Tab.12).

Tab.12. Foshnjat e lindura pa jetë sipas institucioneve shëndetësore, 2019

Nr	Institucioni	Prej tyre të lindura pa jetë	
		N	%
1	QKUK	92	63.4
2	Spitalet e përgjithshme	48	27.9
3	Maternitetet jashtëspitalore	1	0.7
4	Institucionet publike	141	97.2
5	Institucionet private	4	2.8
6	Gjithsej	145	100.0

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2019


Sipas IKSHPK-së, në nivelin terciar në QKUK, në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike, vdekshmëria fetale është më e larta me 9.5%. Sa i përket spitaleve rajonale, spitali i Gjilanit dhe Pejës kanë shkallën më të lartë të vdekshmërisë fetale (6.2%), pasuar nga spitali i Vushtrrisë me 5.7% dhe Spitali i Prizrenit 4.1%. Spitali i Ferizajit nuk ka raportuar asnjë rast të vdekjeve fetale. Maternitetet e KPSH-së kanë raportuar 1vdekje fetale, kurse në institucionet private janë regjistruar 4 vdekje fetale. (Graf.8).



Graf. 8 Vdekshmëria fetale sipas institucioneve shëndetësore publike

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2019

Vdekshmëria fetale ka trend të rënies me lëvizje variabile. Në vitin 2000 shkalla e vdekshmërisë fetale ishte 14.5% ndërsa në vitin 2019 është 4.6% (Graf.9).



Graf. 9 Shkalla e vdekshmërisë fetale, 2000-2019


Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2019

VDEKSHMËRIA PERINATALE

Shkalla e vdekshmërisë perinatale në vitin 2019 në Kosovë është 10.0%.

Sipas të dhënave në dispozicion nga ASK, mortaliteti perinatal për periudhën 2011-2019 tregon tendencë shumë të lehtë të rënies mesatare me 0.1%, mirëpo me lëvizje variabile (Graf.10).

Sipas komunave shkalla më e lartë e vdekshmërisë perinatale është në komunën e Prishtinës dhe Deçanit me 15.5%, Kaçanik 13.8% dhe Ferizaj me 12.9% ndërsa shkallë më të ultë kishte në komunën e Pejës me 2.8% dhe Istogut me 2.5% (Tab.14).



Graf. 10. Trendi i mortalitetit perinatal, 2000-2019

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2019

Sipas gjinisë, mortaliteti perinatal është më i lartë te gjinia mashkullore (10.3%), (Tab.13).

Tab.13. Mortaliteti Perinatal sipas gjinisë

Indikatori	Mortaliteti perinatal (Meshkuj)	Mortaliteti perinatal (Femra)	Mortaliteti Perinatal
%	10.3	9.8	10.0

Vdekshmëria e hershme neonatale (0 – 6 ditë)

Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale (0 – 6 ditë) për vitin 2019 është 5.4%. Sipas vendbanimit të foshnjeve, shkalla më e lartë e vdekshmërisë së hershme neonatale është në komunën e Kaçanikut 11.0 %, Deçanit 9.3%, dhe me nga 8.8% Prishtinës dhe Hanit të Elezit (Tab.15).

Vdekshmëria neonatale e vonshme (7 – 27 ditë)

Shkalla e vdekshmërisë së vonshme neonatale (7 – 27 ditë) për vitin 2019 është 2.1%. Sipas komunave, shkalla më e lartë e vdekshmërisë së vonshme neonatale është në komunën e Kamenicës 8.8%, Gjilanit 5.1%, dhe Dragashit 3.7% (Tab.15).

Vdekshmëria neonatale (0-28 ditë)

Shkalla e vdekshmërisë neonatale (0-28 ditë) për vitin 2019 është 7.4%. Sipas komunave, shkalla më e lartë e vdekshmërisë neonatale është në komunën e Kaçanikut 13.8%, Prishtinës 11.7%, dhe Mitrovicës 11.5% (Tab.15).

Vdekshmëria postneonatale (28-364 ditë)

Vdekshmëria postneonatale për vitin 2019 është 1.2%. Shkalla më e lartë e vdekshmërisë postneonatale është në komunën e Novobërdës 19.6%, Dragashit 3.7% dhe Vitisë 1.9% (Tab.15).

Tab. 14. Shkalla e vdekshmërisë perinatale dhe infantile sipas komunave, 2019

Komuna	Mortaliteti infantil	Mortaliteti perinatal
Deçan	9.3	15.5
Gjakovë	3.8	4.8
Gllgovc	9.5	12.2
Gjilan	11.1	10.3
Dragash	7.4	0.0
Istog	2.5	2.5
Kaçanik	13.8	13.8
Klinë	0.0	6.9
Fushë Kosovë	5.9	8.3
Kamenicë	8.8	4.4
Mitrovicë	12.5	9.6
Leposaviq	0.0	0.0
Lipjan	6.3	10.1
Novobërdë	19.6	0.0
Obiliq	3.7	0.0
Rahovec	6.5	9.7
Pejë	4.7	2.8
Podujevë	9.9	10.9
Prishtinë	13.3	15.5
Prizren	10.3	12.7
Skenderaj	6.8	10.2
Shtime	0.0	3.5
Shtërpcë	0.0	0.0
Suharekë	10.4	10.4
Ferizaj	6.8	12.9
Viti	9.3	7.5
Vushtri	10.9	10.9
Zubin Potok	0.0	0.0
Zveçan	0.0	0.0
Malishevë	8.1	9.5
Junik	0.0	0.0
Mamushë	0.0	0.0
Hani i Elezit	8.8	8.8
Graçanicë	0.0	0.0
Ranillug	0.0	0.0
Partesh	0.0	0.0
Kllokot	0.0	0.0
Mitrovicë e Veriut	0.0	0.0
Jashtë Kosovës	16.3	24.4
Gjithsej	8.7	10.0

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2019

Tab.15. Shkalla e vdekshmërisë infantile sipas moshës dhe komunave, 2019

Komuna	Mortaliteti neonal			
	Hershëm	Vonshëm	Neonatal	Postneonatal
Deçan	9.3	0.0	9.3	0.0
Gjakovë	1.9	1.0	2.9	1.0
Glllogovc	6.8	1.4	8.1	1.4
Gjilan	4.3	5.1	9.4	1.7
Dragash	0.0	3.7	3.7	3.7
Istog	0.0	0.0	0.0	2.5
Kaçanik	11.0	2.8	13.8	0.0
Klinë	0.0	0.0	0.0	0.0
Fushë Kosovë	2.4	3.5	5.9	0.0
Kamenicë	0.0	8.8	8.8	0.0
Mitrovicë	8.6	2.9	11.5	1.0
Leposaviq	0.0	0.0	0.0	0.0
Lipjan	5.1	1.3	6.3	0.0
Novobërdë	0.0	0.0	0.0	19.6
Obiliq	0.0	3.7	3.7	0.0
Rahovec	6.5	0.0	6.5	0.0
Pejë	0.9	1.9	2.8	1.9
Podujevë	5.0	3.0	8.0	2.0
Prishtinë	8.8	2.8	11.7	1.6
Prizren	6.4	2.4	8.8	1.5
Skenderaj	3.4	1.7	5.1	1.7
Shtime	0.0	0.0	0.0	0.0
Shtërpçë	0.0	0.0	0.0	0.0
Suharekë	7.4	1.5	8.9	1.5
Ferizaj	5.4	0.7	6.1	0.7
Viti	5.6	1.9	7.5	1.9
Vushtrri	7.6	2.2	9.8	1.1
Zubin Potok	0.0	0.0	0.0	0.0
Zveçan	0.0	0.0	0.0	0.0
Malishevë	6.8	0.0	6.8	1.4
Junik	0.0	0.0	0.0	0.0
Mamushë	0.0	0.0	0.0	0.0
Hani i Elezit	8.8	0.0	8.8	0.0
Graçanicë	0.0	0.0	0.0	0.0
Ranillug	0.0	0.0	0.0	0.0
Partesh	0.0	0.0	0.0	0.0
Kllokot	0.0	0.0	0.0	0.0
Mitrovicë e Veriut	0.0	0.0	0.0	0.0
Jashtë Kosovës	0.0	0.0	0.0	0.0
Gjithsej	5.4	2.1	7.4	1.2

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2019

PËRFUNDIMET

- Në vitin 2019, sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë raportuar gjithsej 21,899 lindje, prej tyre 4,364 janë lindje jashtë Kosovës.
- Prej gjithsej lindjeve në Kosovë, të lindur gjallë janë 21,798 dhe 101 të lindur vdekur.
- Sipas gjinisë së të porsalindurve, të gjinisë mashkullore janë 11,452 (52.5%), femra 10,346 (47.5%), me raportin gjinor në lindje prej 1,106 meshkuj në çdo 1,000 femra të lindura gjallë.
- Shkalla e lindjeve me prerje Cezariane është 20.7%.
- Sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në spitalet e përgjithshme me 11,784 apo 53.3%, pason klinika obsterike gjinekologjike e QKUK-së me 9,461 lindje apo 42.8%, në maternitete 278 lindje apo 1.3%, ndërsa në spitalet private, (spitali Bahceci, spitali Amerikan, spitali Lindja, spitali Sirona) 587 lindje ose 2.7%.
- Sipas komunave më së shumti të lindur gjallë janë raportuar në komunën e Prishtinës me 3,266 (12.4%) komunën e Prizrenit me 2,633 (10.0%) dhe komunën e Ferizajit me 1,707 (6.5%).
- Gjatë periudhës kohore 2000-2019 ka rënie mesatare prej 758 lindjeve në vit.
- Lindshmëria për periudhën 2000-2019 ka trend të rënies me lëvizje variable.
- Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore më i larti është në klinikën Gjinekologjike Obsterike të QKUK-së me 25.9 lindje, pason Prizreni me 8.5 lindje, Gjakova me 5.2 lindje dhe më së paku në Vushtrri me 1 lindje në ditë.
- Me grup-peshë < 2500g janë 1,121 apo 5.1% të foshnjave të porsalindura.
- Moshja mesatare e nënave është moshja 29 vjeçare.
- Lindjet me prerje cezariane krahasuar me vitin 2015 kanë rënie prej 27.3% në 20.7%.
- Në institucionet publike nga gjithsej 21,523 lindje, 4,105 (19.1%) janë me prerje cezariane ndërsa në institucionet private nga gjithsej 587 lindje, 475 (80.9%) janë me prerje cezariane. Sipas spitaleve, përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariane është realizuar në spitalin e Pejës 676 (38.3%).
- Prej gjithsej 189 foshnjave të vdekura, 118 (62.4%) janë vdekje neonatale të hershme, vdekje neonatale 163 (86.2%), vdekje neonatale të vonshme 45 (23.8%) dhe 26 janë vdekje postneonatale apo (13.8%).
- Mortaliteti neonatal i hershëm është 5.4‰, mortaliteti neonatal i vonshëm 2.1‰ dhe mortaliteti postneonatal 1.2‰.
- Mortaliteti infantil në Kosovë për vitin 2019 është 8.7 ‰. Sipas komunave, më i larti është në komunën e Novobërdës me 19.6‰ dhe Kaçanikut me 13.8‰.
- Nga gjithsej 189 foshnje të vdekura, 97 (51.3%) janë të gjinisë mashkullore dhe 92 (48.7%) të gjinisë femrore, pa dallim sinjifikant sipas gjinisë, moshës së nënës dhe rradhës së lindjes së fëmijës.
- Numri i foshnjave të lindura vdekur për vitin 2019 sipas ASK-së është 101 me vdekshmëri fetale prej 4.6‰.

- Sipas niveleve të Kujdesit Shëndetësor 92 vdekje fetale (63.4%) kanë ndodhë në QKUK, 48 (27.9%) në spitale dhe në maternitete jashtëspitalore 1 (0.7%).
- Në vitin 2019 bazuar në raportet e IKSHPK-së vdekshmëria fetale, sipas institucioneve, është më e larta në QKUK me 9.5%, spitalin e Gjilanit dhe Pejës me nga (6.2%), pasuar me spitalin e Vushtrrisë me 5.7% dhe Spitalin e Prizrenit me 4.1%). Spitali i Ferizajit nuk ka raportuar asnjë rast të vdekjeve fetale për vitin 2019. Maternitetet e KPSH-së kanë raportuar 1 vdekje fetale, kurse në institucionet private janë regjistruar 4 vdekje fetale.
- Në vitin 2019 në Kosovë, shkalla e vdekshmërisë perinatale është 10.0%.
- Sipas të dhënave në dispozicion nga ASK, mortaliteti perinatal për periudhën 2011-2019 tregon tendencë shumë të lehtë të rënies mesatare me 0.1%, mirëpo me lëvizje variabile.
- Sipas komunave shkalla më e lartë e vdekshmërisë perinatale është në komunën e Prishtinës dhe Deçanit me 15.5%, Kaçanikut 13.8%, dhe Ferizajit me 12.9% ndërsa shkallë më të ultë ka në komunën e Pejës me 2.8% dhe Istogut me 2.5%.

REKOMANDIMET

- Në raportim të të dhënave perinatale të përfshihen të gjitha institucionet, publike dhe private si dhe të gjitha komunat.
- Të zbatohet në praktikë pyetësi i unifikuar për mbledhjen e të dhënave mes institucioneve relevante.
- Të organizohen trajnime të punëtorëve shëndetësorë për kodimin e shkaqeve të vdekjeve.
- Të sigurohet niveli i raportimit të të dhënave për vdekjet maternale dhe shkaqet e vdekjeve të foshnjeve.
- Të fuqizohet qasja multidisiplinare në përmirësimin e kujdesit prenatal, kujdesit natal përmes organizimit të aktiviteteve sipas pakos së OBSH-së “Every Newborn action plan to end preventable deaths.
- Të hartohen udhërrëfyesit dhe protokolet klinike relevante dhe të monitorohet zbatimi i tyre në praktikë.
- Të realizohet vlerësimi i cilësisë së institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të planifikohet konform të gjeturave nga vlerësimi i performancës së institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të fuqizohet më tutje edukimi i vazhdueshëm profesional i punëtorëve shëndetësor.
- Të zgjerohet programi i vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë në të gjitha komunat.
- Të përmirësohet infrastruktura, pajisjet dhe furnizimi me barna në institucione që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të punohet në ngritjen e nivelit të njohurive për shëndetin e nënës dhe fëmijës përmes programeve dhe aktiviteteve të promovimit dhe edukimit shëndetësor në Kosovë.

BIBLIOGRAFIA

- 1. IKSHPK, Lindjet 2019**
- 2. ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2019**
- 3. ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2019**
- 4. Raporti Perinal European, 2015**

ANEKS

Të dhënat për lindjet dhe vdekjet e foshnjeve sipas komunave, 2019-Kosovë

K o m u n a t	Gjithsej lindje	Gjithsej lindje të gjalla	Lindur gjallë		Të lindur vdekur	Deri ne 24 orë	1-6 ditë	7-27 ditë	28-31 ditë	1-3 muaj	4-7 muaj	8-11 muaj	<1 vit
			Femra	Meshkuj									
Deçan	324	322	156	166	2	0	3	0	0	0	0	0	3
Gjakovë	1046	1043	468	575	3	0	2	1	0	0	1	0	4
Glogovc	742	738	341	397	4	3	2	1	0	0	1	0	7
Gjilan	1174	1167	540	627	7	1	4	6	0	1	1	0	13
Dragash	269	269	125	144	0	0	0	1	0	1	0	0	2
Istog	400	399	211	188	1	0	0	0	0	0	0	1	1
Kaçanik	364	363	178	185	1	2	2	1	0	0	0	0	5
Klinë	435	432	197	235	3	0	0	0	0	0	0	0	0
Fushë Kosovë	851	846	398	448	5	1	1	3	0	0	0	0	5
Kamenicë	229	228	102	126	1	0	0	2	0	0	0	0	2
Mitrovicë	1044	1043	511	532	1	1	8	3	0	1	0	0	13
Leposaviq	35	35	17	18	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Lipjan	796	792	390	402	4	0	4	1	0	0	0	0	5
Novobërdë	51	51	13	38	0	0	0	0	0	0	1	0	1
Obiliq	268	268	132	136	0	0	0	1	0	0	0	0	1
Rahovec	618	616	285	331	2	0	4	0	0	0	0	0	4
Pejë	1077	1075	478	597	2	0	1	2	0	1	0	1	5
Podujevë	1012	1006	493	513	6	1	4	3	0	1	0	1	10
Prishtinë	3188	3167	1498	1669	21	7	21	9	1	2	2	0	42
Prizren	2059	2046	985	1061	13	4	9	5	0	0	2	1	21
Skenderaj	593	589	277	312	4	1	1	1	0	0	0	1	4
Shtime	288	287	119	168	1	0	0	0	0	0	0	0	0
Shtërpcë	62	62	29	33	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Suharek	678	676	344	332	2	1	4	1	0	1	0	0	7
Ferizaj	1485	1474	742	732	11	2	6	1	1	0	0	0	10
Viti	536	535	258	277	1	1	2	1	0	0	1	0	5
Vushtrri	920	917	411	506	3	1	6	2	0	0	0	1	10
Zubin Potok	57	57	22	35	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Zveçan	19	19	13	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Malishevë	739	737	350	387	2	2	3	0	0	0	1	0	6
Junik	37	37	20	17	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mamush	77	77	36	41	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Hani i Elezit	114	114	53	61	0	0	1	0	0	0	0	0	1
Graçanicë	25	25	17	8	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ranillug	19	19	12	7	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Partesh	27	27	11	16	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kllokot	33	33	17	16	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mitrovica e Veriut	84	84	47	37	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Jashtë Kosovës	124	123	50	73	1	0	0	0	0	0	0	0	2
Gjithsej	21899	21798	10346	11452	101	28	88	45	2	8	10	6	189